



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 18132 prot.

Vlorë, më ____ .09.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

NJËSIA ADMINISTRATIVE NOVOSELË

DATË 26.08.2026 ORA 10:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2027 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.16533 prot, datë 13.08.2026.

Marrin pjesë:

Kryetare e Bashkisë Vlorë znj.Brunilda Mersini, Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Kryetari i N.J.A.Novoselë- z.Kanan Shakaj, Drejtor i Financës – z. Hiqmet Haxhaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak -znj.Leonela Dautaj, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 32 persona)

Takimin e hap Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj.Brunilda Mersin: Përshëndetje dhe faleminderit që iu përgjigjët thirrjes sonë. Buxheti kryesor është përqendruar në qytetin e Vlorës, por është e rëndësishme që ai të ndahet dhe të adresojë nevojat e të gjitha njësive administrative. Dua të bëj një përmbledhje të punëve të realizuara gjatë vitit 2026, i cili po shkon drejt përfundimit. Gjatë këtij viti, fokusi kryesor ka qenë te punët publike dhe përmirësimi i infrastrukturës në qytetin e Vlorës. Në pjesën më të madhe, ndërhyrjet

infrastrukturore janë drejt përfundimit. Një tjetër prioritet ka qenë arsimi. Në Njësinë Administrative Novoselë kemi planifikuar ndërhyrje për ndërtimin e shkollës dhe kopshtit. Në vitin 2027, vëmendja jonë do të përqendrohet edhe më shumë te njësitë administrative. Kemi planifikuar ndërtimin e një këndi lojërash dhe një terreni sportiv, si dhe ndërhyrje për përmirësimin e ndriçimit publik. Një nga problemet kryesore të ngritura nga banorët është furnizimi me ujë. Ky problem do të jetë një nga prioritetet tona, veçanërisht në Njësinë Administrative Novoselë, ku do të punojmë për përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë. Banor: Investimet në Njësinë Administrative janë të domosdoshme. Një nga problemet kryesore që hasim është mungesa e ujit.



Banor: Kemi problem me furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimet, infrastrukturën rrugore dhe pastrimin. Gjithashtu, nevojitet ndërhyrje për rikonstruksionin e pallateve.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersin: Shqetësimin për furnizimin me ujë e kam përcjellë dhe e kam ngritur pranë institucioneve përgjegjëse. Për sa i përket Ujësjiellësit, nuk kam kompetencë

Banor i fshatit Çerkovinë: Problemet kryesore janë mungesa e ujit dhe përroi, i cili gjatë reshjeve krijon përmbytje dhe ka nevojë për pastrim. Gjithashtu, rrugët e brendshme të fshatit janë në gjendje të amortizuar dhe të vështira për t'u kaluar. Është e nevojshme edhe ndërhyrja me skrep për pastrimin e ferrave.

Banor i fshatit Bishan: Nevojë për ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj.Brunilda Mersin: Ky problem nuk është në kompetencë të Bashkisë.

Banor i fshatit Mifol: Problematikat kryesore janë pastrimi i kanalit, si dhe nevoja për instalimin e një rrjeti të ri të furnizimit me ujë në lagjen e Çobajve. Gjithashtu, kërkohet ndërhyrje në rrugën që të çon te varrezat dhe në rrugët e brendshme të fshatit. Nevojitet gjithashtu ndërhyrje në rrugën pranë shkollës dhe vijimin e punimeve në segmentet e tjera të nevojshme.

Znj. Milika Hyso: Nevojë për krasitjen e pemëve. Gjithashtu, problematikë mbetet pajisja me certifikatën e pronësisë së tokës.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj.Brunilda Mersin: Pranë çdo njësie administrative do të ketë një specialist, i cili do të merret me shërbimet nëpërmjet sistemit e-Albania dhe do t'u vijë në ndihmë banorëve për çdo nevojë.

Banor: Problematikat kryesore janë mungesa e ujit, gjendja e rrugëve dhe mungesa e investimeve në zonë.

Banor i fshatit Bishan: Problem shqetësues është prania e kafshëve, e cila krijon aroma të pakëndshme për banorët. Gjithashtu, nevojitet zgjerimi i rrugëve, pasi hapësirat janë ngushtuar për shkak të rrethimeve të pallateve. Kërkohet ndërhyrje për rikonstruksionin dhe përmirësimin e fushës sportive. Një tjetër problematikë është gjendja e varrezave të fshatit, ku nevojitet zgjerimi i hapësirës për të krijuar më shumë vende.

Banor i fshatit Poro: Problemet kryesore lidhen me ndërhyrjet e Ujësjellësit, të cilat kanë shkaktuar problematika në zonë. Gjithashtu, kërkohet hapja dhe sistemimi i rrugës që lidh fshatin Poro me Delisufin.

Banor i fshatit Bishan: Nevojiten ndërhyrje dhe investime në fshat, pasi prej një kohe të gjatë nuk janë realizuar investime të mjaftueshme për përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve.

Banor i fshatit Novoselë: Nevojë për ndërhyrje në rrugët e fshatit dhe për një mjet për pastrimin e ferrave dhe mirëmbajtjen e hapësirave. Gjithashtu, vuajmë mungesën e ujit, ndërsa gjatë periudhës së dimrit përballemi me problematika të përmbytjeve.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj.Brunilda Mersin: Duhet të hartohet një program për vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme për çdo njësi administrative, në mënyrë që të sigurohet mirëmbajtja dhe ndërhyrja në kohë sipas problematikave të secilës njësi.

Banor i fshatit Delisuf: Problematikat kryesore janë mungesa e ndriçimit, gjendja e rrugëve dhe nevoja për pastrimin e kanaleve.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj.Brunilda Mersin: Do të jetë një angazhim i vazhdueshëm i imi për ndjekjen e problematikave dhe bashkëpunimin me Ujësjetllësin, me qëllim përmirësimin e furnizimit me ujë dhe shërbimeve në zonë.

Faleminderit!

Konceptoi:

Aurora Kamberaj

Koordinatore për Njoftim dhe Konsultim Publik

